



Republika e Kosovës
Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 3771/2024
Nr.i fqj/Br.str./Nr.pg.
Data/Datum/Date: 13/05/2024



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

OPINION

I

AVOKATIT TË POPULLIT

A. nr. 295/2022

*përkitazi me pretendimin për cenim të lirisë së asociimit dhe ushtrimit të aktivitetit sindikal
si dhe diskriminim për shkak të angazhimit sindikal*

Drejtuar:

Z. Hekuran Murati, ministër
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Komiteti për Partneritet Publiko – Privat dhe
Departamenti Qendror për Partneritet Publiko Privat – Ministria e Financave

Z. Haldun Fırat Köktürk – drejtor menaxhues
Limak Kosovo International Airport J.S.C. SH.A

Në dijeni të:

Z. Liburn Aliu, ministër
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Z. Izedin Bytyqi, Zv. Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

Z. Enis Spahiu, Zv. Sekretar i Përgjithshëm
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Z. Hekuran Nikçi, Kryeinspektor
Inspektorati i Punës

Prishtinë, 13 maj 2024

Qëllimi

1. Ky opinion pasqyron qëndrimet dhe konstatimet e Avokatit të Popullit lidhur me cenimin e lirisë së asociimit dhe të organizimit të aktivitetit sindikal të të punësuarve të Limak Kosovo International Airport J.S.C. “Adem Jashari” (Limak - Aeroporti Ndërkontrollor i Prishtinës “Adem Jashari” – më tej referuar si: ANP).
2. Opinion i bazohet në ankesën e pranuar nga z. Bashkim Latifi, në cilësi të kryetarit të Shoqatës Sindikale Aeroporti Ndërkontrollor Adem Jashari, me pretendimet: për largim nga puna të 51 punëtorëve të ANP-së, pas grevës së mbajtur në vitin 2019, e organizuar me kërkesë për kushte më të mira të punës. Poashtu ankesa ka të bëjë edhe me pretendimet për moslejimin e kryetarit të sindikatës për qasje në zyrat dhe në dosjet e sindikatës dhe ushtrimin e aktivitetit sindikal si dhe pretendimet për shkeljen e vazhdueshme të të drejtave nga marrëdhënia e punës e punëtorëve të ANP-së.
3. Opinion i mëton të sjellë në vëmendjen e autoriteteve kompetente, nevojën për ndërmarrjen e masave për sigurimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit në fuqi, e veçanërisht të Ligjit të Punës dhe të Ligjit për Organizimin Sindikal, garantimin e mbrojtjes së të drejtave nga marrëdhënia e punës, dhe ndalimin e diskriminimit të punëtorëve të ANP-së mbi bazën e anëtarësimit në sindikatë dhe mbi bazën e angazhimit në aktivitete sindikale.

Baza kushtetuese dhe ligjore

4. Në pajtim me nenin 132, paragrafi 1, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “*Avokati i Popullit mbikëqyr dhe mbron të drejtat dhe liritë e individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike.*” Kushtetuta më tej në nenin 135, paragrafi 3, përcakton: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*”
5. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - “*Për t'i hetuar ankesat e pranuara nga çdo person fizik a juridik lidhur me pothimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit*” (neni 16, paragrafi 1);
 - “*publikon raporte dhe bën rekomandime mbi politikat dhe praktikat për të luftuar diskriminimin dhe promovuar barazinë* (neni 16, paragrafi 15);
 - “*të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tillë dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tillë*” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2);
 - “*të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avansimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit* (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5);

- “*t’i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta*” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6).
 - “*Avokati i Popullit mund t’i këshillojë dhe t’u rekomandojë autoriteteteve të Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës*” (neni 18, paragrafi 3).
6. Gjithashtu, duke iu referuar Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, Avokati i Popullit është institucion i shtetit, i cili bën promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe trajton rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin sipas ligjit përkatës për Avokatin e Popullit, njëherësh ka këto kompetenca si në vijim:
- *pranon dhe heton parashtresat e personave, ndërmjetëson, jep mendime dhe rekomandime për rastet konkrete të diskriminimit* (neni 9, paragrafi 2, nënparagrafi 2.1);
 - *informon publikun për rastet e diskriminimit dhe ndërmerr masa për promovimin e barazisë, të drejtave të njeriut dhe mos diskriminimin* (neni 9, paragrafi 2, nënparagrafi 2.5);
 - *ofron këshilla, udhëzime dhe mbështetje, subjekteve të sektorit publik dhe privat mbi praktikat e mira në promovimin e barazisë, ... dhe jep rekomandime për marrjen e masave për promovimin e barazisë, përshtatjen ndaj diversitetit dhe/ose luftimin e diskriminimit* (neni 9, paragrafi 2, nënparagarfi 2.7).
 - *Çdo person apo grup i personave mund t’i parashtrojë ankesë Avokatit të Popullit lidhur me sjelljen diskriminuese mbi bazat e përmendura në nenin një (1) të këtij Ligji.* (neni 12, paragrafi 1).

Rrethanat e rastit dhe veprimet e Institucionit të Avokatit të Popullit

7. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 10 maj 2022 kishte pranuar ankesë nga z. Bashkim Latifi – në cilësi të kryetarit të Shoqatës Sindikale Aeroporti Ndërkombëtar Adem Jashari, parashtuar kundër Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, me pretendimin për moslejim të ushtrimit të aktivitetit sindikal, diskriminim të punëtorëve dhe largim kolektiv të punëtorëve nga puna, për shkak të asociiut në sindikatë.
8. Më 7 qershor 2022, përfaqësuesja e IAP-së, në takimin e mbajtur me kryetarin dhe përfaqësues të tjerë të sindikatës, ishte njoftuar se, si rezultat i pakënaqësive të shumta, punëtorët e ANP-së në vitin 2019 kishin mbajtur një grevë 3-ditore. Pas periudhës 6-mujore, ANP-ja kishte larguar nga puna mbi 50 punëtorë, në mesin e tyre edhe kryetarin e Sindikatës. Sipas pretendimit të tij, si rezultat i largimit nga puna të shumë punëtorëve, ishte rritur vëllimi dhe presioni në pjesën tjeter të stafit të mbetur në punë, mbi kryerjen e detyrave të punës. Sipas ankuesve, për arsyet e zgjelimit të numrit të punëtorëve, pjesa e mbetur e punëtorëve ishin obliguar të punonin me orar të zgjatur të punës si edhe gjatë ndërrimit të natës. Sipas informatave, ndaj punëtorëve grevistë me kalimin e kohës kishte filluar ndërmarrja e masave, si: iniciimi i procedurave disiplinore, ulja e notave të vlerësimit të performancës në punë, e deri tek largimi nga puna.
9. Më 13 qershor dhe më 21 qershor 2022 ankuesi kishte dorëzuar në IAP dokumentacionin shtesë të kërkuar nga IAP-ja, lidhur me pretendimet e ankuesit si dhe procedurat e

ndjekura nga palët në raport me çështjet e ngitura në Inspektoratin e Punës dhe në gjykatë, të cilët janë të paraqitura si më poshtë:

9.1 Inspektorati i Punës, më 2 prill 2020, kishte nxjerrë Vendimin nr. Rap 01-14-66/2020-1, me të cilin, ankesa e parashtruar nga Shoqata Sindikale e Punëdhënësit Limak Kosovo International Airport J.S.C., përkitazi me pretendimet për shkelje ligjore me rastin e largimit nga puna të punonjësve të aeroportit, është shpallur e bazuar. Me këtë vendim punëdhënësi ishte obliguar që në afat prej 8 ditësh t'i anulonte vendimet për mosvazhdim të marrëdhënies të punës për 23 punonjësit e larguar; t'i anulonte njoftimet për mosvazhdim të marrëdhënies së punës për 28 punonjësit e tjerë; t'i rishqyrtopte njoftimet dhe vendimet për mosvazhdim të marrëdhënies së punës të punonjësve dhe, me rastin e rishqyrtimit të njoftimeve dhe vendimeve për mosvazhdimin e marrëdhënies së punës të punonjëseve, të shmangente diskriminimin në raport me punonjësit e tjerë të cilët janë në marrëdhënie pune tek punëdhënësi. Në arsyetim të vendimit ndër të tjera potencohej se, pas inspektimit të dokumentacionit të ofruar nga punëdhënësi, vërehej se punonjësit të cilëve u ishte dhënë njoftimi për mosvazhdim të kontratës rezultotonin të ishin anëtarë të Shoqatës Sindikale, të cilët kanë qenë edhe pjesëmarrës në grevën e organizuar ndërmjet datave 19, 20, 21 gusht 2019, me pretendim për cenim të së drejtës për trajtim të barabartë në punë dhe në proceset e punës.

9.2 Vendimi i lartpërmendur ishte vërtetuar edhe nga Shkalla e dytë e Inspektoratit të Punës, përmes Vendimit nr. 386/2020, i nxjerrë më 6 gusht 2020, me të cilin ishte refuzuar si e pabuar ankesa e parashtruar nga punëdhënësi dhe ishte miratuar Vendimi nr. 01-14-66/2020-1 i shkallës së parë të IP-së.

(Në vazhdim janë disa nga vendimet e nxjerra në procedurë gjyqësore, përkitazi me mosvazhdimin e kontratës së punës të punonjësve të aeroportit):

9.3 Më 2 nëntor 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë (GjThP) - Dega në Lipjan kishte nxjerrë Aktgjykimin C.nr. 504/20, me të cilin kishte aprovuar kërkesëpadinë e paditëses Z. B., si të bazuar, duke anuluar njoftimin për mosvazhdim të kontratës së punës, të datës 4 prill 2020, të së paditurës Limak Kosovo International Airport J.S.C, ashtu që e paditura ishte detyruar që në afat prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të aktgjykimit, paditësen ta kthente në punë dhe t'ia kompensonte dëmin material [...] në emër të pagave neto [...]. Ndër të tjerash, në këtë aktgjykim gjykata kishte konstatuar se njoftimi për mospërtëritjen e kontratës së punës 'të së paditurës ishte i kundërligjshëm dhe i pabuar, pasi ishte në kundërshtim me nenet 10 dhe 11 të Ligjit të Punës, duke bërë shkelje të nenit 5 të ligjit, ku është i paraparë se është i *ndlaluar diskriminimi në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnim, promovim të punësimit, kushtet e punësimit, masat disciplinore, ndërprerjen e kontratës së punës dhe çështjeve tjera nga marrëdhënia e punës*.

9.4 Më 12 tetor 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë (GjThP) - Dega në Lipjan kishte nxjerrë Aktgjykimin C.nr. 484/20, me të cilin kishte aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit F. G., duke anuluar njoftimin e së paditurës Limak Kosova International Airport Adem Jashari, për mosvazhdim të kontratës së punës të datës 6 mars 2020, duke detyruar të paditurën që paditësin ta kthente në vendin e mëparshëm të punës dhe t'ia kompensonte të ardhurat personale për kohën 4 prill 2020 deri më 22

shkurt 2021 [...]. Arsyetimi i këtij vendimi ndër të tjerash potenconte: “*Gjykata konsideroi se njoftimi për mospërtrirjen e kontratës së punës të lëshuar nga e paditura është i kundërligjshëm, dhe në kundërtshim me dispozitën e nenit 13 të Ligjit për greva [...].*”

9.5 Më 19 tetor 2020, GjThP-ja - Dega në Lipjan kishte nxjerrë Aktgjykimin C.nr. 495/2020, me të cilin kishte aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit A. M., duke anuluar njoftimin e së paditurës për mosvazhdim të kontratës së punës të datës 4 mars 2020, duke detyruar të paditurën Limak Kosovo International Airport, që paditësin ta kthente në punë dhe të ia kompensonte dëmin material [...] në emër të pagave neto [...].

9.6 Më 21 korrik 2021, GjThP-ja - Dega në Lipjan kishte nxjerrë Aktgjykimin C.nr. 480/2020, me të cilin kishte aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit S. H., duke anuluar njoftimin e së paditurës për mosvazhdim të kontratës së punës të datës 6 mars 2020, duke detyruar të paditurën Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës Limak Kosova, që paditësin ta kthente në punë dhe t'ia kompensonte dëmin material [...] për shkak të mosrealizimit të pagave për periudhën [...].

Në arsyetim të këtij vendimi gjykata ndër të tjerash kishte theksuar : “*Me njoftimin për mosvazhdimin e kontratës së punës është cenuar dispozita e nenit 13 të Ligjit për greva, sepse e paditura që nga koha e mbajtjes së grevave të punëtorëve më datën 21 gusht 2019, ka mbajtur trajnime me punëtor të ri dhe prej mbajtjes së grevave të punëtorëve e deri kur nuk ju ka vazduhar kontrata e punës paditësit, ka pranuar 64 punëtorë të ri. astaj po në këtë periudhë 51 punëtorëve nuk u është vazduhar kontrata e punës dhe tre punëtorëve u ëshi ndërprerë kontrata e punës, vetëm e vetëm se paditësi ka qenë një prej grevistëve të grevës së datës 19, 20 dhe 21 gusht të vitit 2019 dhe edhe përkundër marrëveshjes së arritur në mes të shoqatës së sinidkatave të punëtorëve të aeroportit dhe menaxhmentit të aeroportit, të arritur në takimin e datës 23 gusht 2019, se grevistët nuk do të kenë pasoja për shkak të marrjes pjesë në këto greva.*”

Po ashtu edhe në një rast tjeter, GjThP-ja – Dega në Lipjan më 23 gusht 2021 kishte nxjerrë Aktgjykimin C.nr. 486/2020, me të cilin kishte aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit H. K., duke anuluar njoftimin e së paditurës për mosvazhdim të kontratës së punës të datës 6 mars 2020, duke detyruar të paditurën Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës Limak Kosova, që paditësin ta kthente në punë dhe t'ia kompensonte dëmin material [...] për shkak të mosrealizimit të të ardhurave personale për periudhën kohore [...].

Sipas kërkesës së Zyrës së Avokatit të Popullit, më 12 mars 2024, ankuesi ia ka bashkëngjitur dosjes së lëndës disa vendime edhe të gjykatës së shkallës së dytë. Sipas dokumentacionit të sjellë kuptohet se Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit Ac.nr 7420/2021, kishte refuzuar si të pathemeltë ankesën e së paditurës Aeroporti Ndërkombëtar Limak Kosova International Airport J.S.C., me seli në Vrellë, komuna e Lipjanit, ndërsa Aktgjykimi C.nr. 486/20 i Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, i datës 24 maj 2021, ishte vërtetuar (objekt kontesti në këtë lëndë ka qenë anulimi i vendimit dhe kthimi në vendim e punës i H. K. dhe kompensimi i të ardhurave personale). Po ashtu Gjykata e Apelit edhe në një vendim tjeter kishte

vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, me të njëjtin objekt kontesti. Sipas Aktgjykimit Ac.nr. 8016/2021, i nxjerrë më 18 janar 2023, Gjykata e Apelit kishte refuzuar ankesën e së paditurës Aeroporti Ndërkombëtar Limak Kosova J.S.C. Adem Jashari, me seli në Vrellë, komuna e Lipjanit, duke vërtetuar Aktgjykimin C.nr. 465/2020 e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, datë 21 korrik 2021.

- 9.7 Për sa i përket ndërprerjes së aktivitetit sindikal, z. Latifi më 4 mars 2021 kishte parashtruar ankesë në Inspektoratin e Punës, me pretendimin se ANP-ja kishte ndërmarrë veprime për ndalimin e qasjes së tij në cilësi të kryetarit të Sindikatës në zyrën e Sindikatës, me arsyetimin e dhënë nga ANP-ja se kjo kishte ndodhur për shkak të ndërprerjes së përkohshme të marrëdhënieς së punës.
- 9.8 Më 23 tetor 2021, lidhur me ankesën e parashtruar nga kryetari i sindikatës z. Latifi, përkizati me ndërprerjen e aktivitetit sindikal, Inspektorati i Punës kishte nxjerrë Vendimin 01 nr. 12-152/21, me të cilin kishte shpallur të bazuar ankesën e tij, ndaj punëdhënësit Limak Kosova International Airport, për shkak të ndërprerjes së aktivitetit sindikal, meqë të njëjt pas ndërprerjes së marrëdhënieς së punës i ishte mohuar edhe ushtrimi i aktivitetit sindikal.
- 9.9 Më 27 korrik 2022, Organi i shkallës së dytë i Inspektoratit të Punës, duke vepruar sipas ankesës së punëdhënësit, përmes Vendimit nr. 518/2022 kishte shfuqizuar sipas detyrës zyrtare Vendimin 01 nr. 12-152/21 të Organit të shkallës së parë të Inspektoratit të Punës dhe lëndën e kishte kthyer për rishqyrtim dhe rivendosje te inspektori i lëndës.
- 9.10 Më 24 janar 2021, z. Latifi përmes komunikimit me postë elektronike i ishte drejtuar udhëheqësit të Divizionit për Siguri të Avacionit Civil në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), me kërkesë për sqarim në lidhje me Vendimin nr. 0031 për tërheqjen e certifikatës së punës si operator i skanimit në aeroport, ku ndër të tjera kishte kërkuar informata nëse autoriteti në fjalë kishte kërkuar ndalimin e qasjes së tij në hapësirat e aeroportit për aktivitete sindikale, përfshirë këtu edhe qasjen në zyrën e Sindikatës ku ushtrohej aktiviteti sindikal i Sindikatës. Kjo pasi sipas pohimit të z. Latifit, drejtori i Burimeve Njerëzore në aeroport, ndalimin e qasjes së tij në aeroport e ndërlidhte me vendimin e MPB-së për ndalimin e qasjes në zonën e kufizuar të sigurisë.
- 9.11 Më 3 shkurt 2021, udhëheqësi i Divizionit për Siguri të Avacionit Civil në MPB, ndër çështjet e ndryshme, përmes postës elektronike kishte njoftuar z. Latifin: “*Ne si autoritet përgjegjës për siguri të avacionit civil, nuk kemi kërkuar nga aeroporti ndalimin e qasjes në zonën e kufizuar të aeroportit, përderisa nuk keni shkelur pikën 5.1.6 të Programit Kombëtar Trajnues për Siguri të Avacionit Civil për Republikën e Kosovës (Revizioni nr. 3), e cila specifikon se kur mundet t’i tërheq/ndalohet hyrja një zyrtari në zonën e kufizuar të aeroportit [...], mirëpo duhet theksuar se aeroporti menaxhon me qasjen e personave në zonën e kufizuar të aeroportit në përputhje me Programin e Sigurimit të Aeroportit (Versioni 6.0, Revizioni 1.1), ata vlerësojnë se kush duhet të ketë qasje në zonën e kufizuar të sigurisë për çështje operacionale, duke mos shkelur pikën e lartcekur (5.1.6).*”
- 9.12 Më 16 shtator 2021, kryetari i Federatës së Sindikatës së Pavarur për Komunikacion e Lidhje të Kosovës, përmes një shkresë i ishte drejtuar menaxhmentit të ANP-së, me

kérkesë që t'ia mundësonte kryetarit të sindikatës së ANP-së, z. Latifit, të kishte qasje në aeroport për një orë në ditë gjatë ditëve të punës, për takim me anëtarët e Sindikatës (punëtorët e ANP-së), me qëllim njoftimin e sindikalisteve me të drejtën e tyre që ua garanton ligji për të zgjedhë dhe për t'u zgjedhur. Lidhur me këtë kérkesë, përgjigjja e ofruar nga Zyra për Burime Njerëzore në ANP kishte qenë: “*Për shkak të shkeljeve të rënda të kodit të etikës dhe procedurës disiplinore dhe si rezultat i cenimit të drejtpërdrejt të sigurisë së aeroportit, kontrata e z. Latifi ka përfunduar dhe si rezultat nuk është në posedim të lejes së sigurisë për hyrje në ambientet e ANP, duke pasur parasysh se certifikata e sigurisë është revokuar nga autoritetet përgjegjëse.*”

9.13 Më 5 mars 2021, Inspektorati i Punës ka përpiluar Raportin Zyrtar të Inspektimit me nr. 01-14-66/2020-2, lidhur me inspektimin e kryer te punëdhënësi Limak Kosovo International Airport JSC, dhe ndër shumë çështje të tjera ka konstatuar këtë gjendje faktike: “Pika 11 (pagat dhe beneficionet e të punësuarve) ku është konstatuar se punëtorët janë të diskriminuar në pagë, pasiqë për të njëtin vend pune me detyra të njëta të punës aplikohen nivele të ndryshme të pagave. Ndërsa pika 17 (liria e organizimit sindikal) konstatohet se: ... *punëdhënësi me veprimet e tij cenon dispozitat e nenit 24 të Ligjit për organizimin sindikal përfshirë në përfaqësimin sindikal ju ndërprenë marrëdhënien e punës; punëdhënësi me veprimet apo mosveprimet e veta cenon të dejtën e organizimit sindikal në kuadër të punëdhënësit; obligohet punëdhënësi që të zbatojë Ligjin për organizimin sindikal në raport me anëtarët dhe përfaqësuesit e sindikatës; punëdhënësi me rastin e inspektimit të rregullt te punëdhënësi përfaqësuesit të sindikatës – kryetarit ua ka mohuar të drejtën e shoqërimit të inspektorëve në të gjitha ambientet e aktivitetit të punëdhënësit, me arsyetimin se MPB ia ka ndaluar hyrjen në ambientet e ANP , pretendim ky i cili nuk qëndron referuar shkresave të dërguara nga Udhëheqësi i Divizionit pë Siguri të Avacionit Civil; punëdhënësi gjithashtu me veprimet e tij për moslejimin e anëtarësimit të punonjësve në organizatën sindikale ka cenuar dispozitën e nenit 4, paragrafi 2 të Ligjit për Organizimin Sindikal, për arsyetimin se punëdhënësi u mohon të drejtën punonjësve për anëtarësim në organizatën sindikale me rastin e mos pranimit të regjistrimit për kuotizim të listës së dërguar nga ana e shoqatës sindikale të punonjësve të cilët duan të jenë pjesë e organizatës sindikale. Punëdhënësi është i obliguar që të eliminonj të metat e konstataura dhe të njoftojë Inspektoratin e Punës për masat e ndërmarra.”*

Disa raste të pretendimeve për shkelje të dispozitave të Ligjit të Punës dhe të të drejtave të garantuara nga marrëdhënia e punës:

9.14 Më 9 nëntor 2021, Inspektorati i Punës, duke vepruar sipas ankesës së z. Latifit, në cilësi të kryetarit të Sindikatës, parashtruar kundër ANP-së, ka nxjerrë Vendimin 01 nr. 08-347/2020-A, me të cilin kishte konstatuar se punëdhënësi me detyrimin/lejimin e punës së punonjësve të X-RAY/skanim, ngarkim dhe shkarkim të bagazheve/valixheve, të punonin më shumë orë jashtë orarit të rregullt të punës, kishte vepruar në kundërshtim të dispozitës së Ligjit nr.03/L-212 të Punës, neni 23, paragrafi 1. Punëdhënësi, me moskompensim të punës jashtë orarit të rregullt të punës, kishte vepruar në kundërshtim të dispozitës së Ligjit nr.03/L-212 të Punës, neni 55, paragrafët 1 dhe 2.

- 9.15 Sipas dokumentacionit të siguruar nga ankuesi, kuptohet se Shoqata Sindikale e ANP-së, e përfaqësuar nga kryetari z. Bashkim Latifi, në cilësi të paditësit, ndaj të paditurës Limak Kosovo International Airport J.S.C. Adem Jashari, më 1 shkurt 2022 kishte iniciuar në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Dega në Lipjan, Padi për kompensimin në pagë për punë jashtë orarit të punës për punonjësit e njësisë të X-RAY, Operator të Skenimit, e cila lëndë, sipas pohimit të z. Latifi, eshtë në shqyrtim e sipër në gjykatë.
- 9.16 Më 15 shkurt 2022, Inspektorati i Punës, duke vepruar sipas ankesës së Sindikatës, kishte nxjerrë Vendimin 01 nr. 12-06/22, me të cilin ishte aprovuar ankesa e parashtruar nga z. Latifi, në cilësi të kryetarit të Sindikatës, ndaj ANP Limak Kosova “Adem Jashari” lidhur me rastin e punonjëses F. M., e cila nuk ishte liruar nga puna e ndërrimit të natës, ndonëse kishte pasur rekomandim mjekësor që për arsyen shëndetësore të lirohej nga puna në këtë orar. Andaj IP-ja kishte kërkuar nga punëdhënësi – ANP-ja – që të vepronte në përputhje me nenin 27, paragrafi 4, të Ligjit të Punës, ku thuhet: “*Në qoftë se të punësuarit gjatë natës, për shkak të punës së bërë sipas vlerësimit të organit kompetent shëndetësor, i përkeqësohet gjendja shëndetësore, punëdhënësi eshtë i detyruar ta caktojë në punë të përshtatshme gjatë orarit të ditës.*”
- 9.17 Sipas shkresës së siguruar nga z. Latifi vërehet se punëtorja e ANP-së, F. P. (njëra nga punëtoret greviste të grevës së vitit 2019), përmes njofimit me postë elektronike kishte njoftuar punëdhënësin për dorëheqje nga marrëdhënia e punës, ku ndër arsyet kryesore potencohej caktimi në punë të natës, ndonëse e njëjta kishte kërkuar që të mos caktohej në ndërrimin e natës, për shkak të kujdesit ndaj vajzës së saj, si nënë vetushqyese. Sipas z. Latifit, kishte pasur disa raste të natyrës së ngjashme ku punëtorëve u ishte imponuar zgjedhja e dorëheqjes.
- 9.18 Lidhur me pretendimin e z. Latifit, për shkelje të tjera dhe të vazhdueshme të dispozitave të Ligjit të Punës, po ashtu kishte bashkëngjitur në dosje të lëndës Raportin Zyrtar të Inspektoratit të Punës RZNr. 01.25-81/2023, lidhur me shqyrtimin e ankesës së punonjëses M. R., ku e njëjta ishte caktuar për të punuar në ndërrimin e natës, ndonëse kishte lajmëruar dhe kërkuar nga ANP-ja që të mos caktohej në këtë ndërrim, meqë ishte nënë vetushqyese e fëmijës së mitur. Në këtë raport IP-ja kishte konstatuar se në rastin e saj kishte shkelje të nenit 27, paragrafi 3, të Ligjit të Punës, ku përcaktohet: “*Ndalohet puna e natës për personat nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç dhe të punësuarat shtatzëna dhe gratë gjidhënëse. Ndërrimet e natës mund të kryhen nga prindërit e vetëm dhe gratë me fëmijë më të rinj se tri (3) vjeç, ose me fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme, vetëm me pëlgimin e tyre.*”
- 9.19 Më 23 gusht 2019, në takimin mes Sindikatës dhe menaxhmetit të aeroportit, sipas pohimit të z. Latifit, ishte nënshkruar marrëveshja ndërmjet përfaqësuesve të punëdhënësit Limak Kosovo Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës dhe përfaqësuesit të Sindikatës së ANP-së “Adem Jashari”, me qëllim të adresimit dhe plotësimit të kërkesave të punëtorëve si në vijim: 1. *Anulimi i pezullimit të qasjes së ID kartelave; 2. Nivelizimi i pagave; 3. Caktimi i zyrës për sindikatë (Palët u dakorduan që sindikatës do t'i caktohet një zyre. Lokacioni i zyrës do të jetë në zonën ku aktualisht janë zyret e Ramp, sepse i gjithë shërbimi i Ramp-it do të zhvendoset dhe atje do të lirohet hapësirë); 4. Përqindja e ndalesës në pagë në rastet kur punëtorët duhet të*

kompenzojnë dëmin e shkaktuar kompanisë; 5. Kohëzgjatja e kontratave (palët u dakorduan që punëtorët të cilët kanë arritur përvojë pune më shumë se 10 vite në kompani, kontratat e tyre të shëndrohen në kontrata me afat të pacaktuar.....);6. Veprimet e punëtorëve gjatë grevës (Palët u dakorduan që punëdhënësi të ndalojë dhe të mos ndërmerr masa dhe nuk do të zhvillojë procedura disiplinore kundër punëtorëve, të cilët gjatë grevës kanë bërë veprime të papërshtathsme); 7. Rritja e pagave për shërbimet e platformës, shërbimit të pasagjerëve, zjarfikësve dhe mirëmbajtjes së fushës ajrore; 8. Ndarja e bonusit të dhënë nga kompanitë ajrore.” Kjo marrëveshje vërehet se ishte nënshkruar dhe vulosur nga anëtari i Bordit dhe kryeshefi ekzekutiv i Limak Kosovo Aeroporti Ndërkombëtar JSC, drejtori i Operimeve të Aeroportit dhe kryetari i Sindikatës së punëtorëve të ANP-së “Adem Jashari”. Megjithatë z. Latifi kishte pohuar se marrëveshja e lartpërmendur nuk ka gjetur zbatim asnjëherë.

10. Më 30 nëntor 2022, përfaqësuesja e IAP-së kishte takuar zyrtarët e Inspektoratit të Punës (IP), nga të cilët ishte njoftuar se në IP ishin iniciuar numër i madh i lëndëve kundër ANP-së, nga të cilat numër i konsiderueshëm kishin përfunduar. Lidhur me mosimplementimin e vendimeve të IP-së, u kuptua se ishin shqiptuar edhe gjoba. Ndërsa, për sa i përket çështjes së kufizimit të aktivitetit sindikal të kryetarit të Sindikatës, është kuptuar se IP-ja në shkallë të parë kishte vendosur në favor të palës, ndërkaq procedura vazhdon të zhvillohet sipas ankesës në shkallë të dytë të IP-së.
11. Më 18 prill 2023, përfaqësuesja e IAP-së ishte takuar me z. Latifin, nga i cili ishte njoftuar se ishin iniciuar 51 procedura gjyqësore në gjykatë lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës të punëtorëve të aeroportit, dhe sipas pretendimit të tij, për 48 raste nga ato ishin dhënë aktgjykime në favor të palëve, në Gjykatë Themelore; 3 janë në pritje për shqyrtim, dhe lëndë të shumta janë në pritje për vendosje nga Gjykata e Apelit; dhe 2 vendime të plotfuqishme në favor të palëve, të cilat janë në procedurë përmbarimi në pritje për ekzekutim (z. Latifi dosjes së lëndës ia ka bashkëngjitur disa vendime të gjykatës themelore, të cilat janë pëershkruar si në fillim të këtij kapitulli).
12. Më 15 gusht 2023, z. Latifi kishte njoftuar IAP-në, me disa shqetësimë se shkeljet e të drejtave të punëtorëve po vazhdonin, si: ndalimi i qasjes në objekt të aeroportit, puna gjatë orarit/ndërrimit të natës e nënave vetushqyese me fëmijë të vegjël, procedura gjyqësore e iniciuar për moskompensim të orëve shtesë të punës etj.
13. Më 17 gusht 2023, Avokati i Popullit përmes një shkresë i ishte drejtuar Kryeinspektorit të Punës, me kërkesë për informata se:
 - Cili është numri i rasteve të iniciuara në IP nga palët/punonjësit e ANP-së “Adem Jashari”, lidhur me pretendimet për shkelje të dispozitave të Ligjit të Punës dhe kufizimit të aktivitetit sindikal nga Limak Kosova – Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”, të vendosura si të bazuara?
 - Cili është numri i rasteve kur janë ekzekutuar gjobat nga ana e IP-së lidhur me mosbatimin e vendimeve të IP-së nga punëdhënësi në fjalë?
 - Në çfarë fazë është duke u trajtuar nga IP-ja çështja e z. Latifit lidhur me ankesën e tij për sa i përket kufizimit të aktivitetit sindikal?

14. Më 31 gusht 2023, Avokati i Popullit, përmes një shkrese zyrtare kishte pranuar nga Kryeinspektor i Inspektoratit të Punës informatat e kërkuara lidhur me çështjen, duke radhitur kronologjikisht të gjitha ankesat e pranuara dhe të trajtuara nga IP-ja, që nga viti 2020, pra nga koha e mbajtjes së grevës në aeroport e tutje. Sipas përgjigjes së pranuar nga IP-ja, rastet e trajtuara nga inspektorati përkizazi me çështjen kanë epilog si në vijim:

1. Ankesa e sindikatës së punëtorëve të aeroportit për ndërprerje të kundërligjshme të marrëdhënies së punës të 51 punëtorëve, në kundërshtim me dispozitën e neneve 70, 71 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, është trajtuar dhe konstatuar si e bazuar dhe është nxjerrë vendim për gjobën në vlerën prej 18.000.00 eurosh.
2. Kërkesa e sindikatës, për inspektim të marrëdhënies së punës dhe sigurisë në punë te punëdhënësi, është trajtuar dhe është nxjerrë vendim, ku është konstatuar përgjegjësia e punëdhënësit në mospërmbushje të detyrimeve nga marrëdhënia e punës, dhe është shqiptuar gjobë në vlerën prej 35.000.00 eurosh.
3. Ankesa për ndërprerje të kundërligjshme të marrëdhënies së punës të 19 punonjësve, është trajtuar nga IP-ja dhe është konstatuar se nuk qëndron pretendimi se punëdhënësi ka bërë ndërprerje të kundërligjshme të marrëdhënies së punës të punëtorëve, sepse të njëjtëve u është dorëzuar në kohë njoftimi për mosvazhdim të marrëdhënies së punës.
4. Ankesa për ndërprerje të marrëdhënies së punës të punonjësit në kundërshtim me dispozitën e neneve 70, 71, 72 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, është trajtuar dhe për cениm të dispozitës së nenit 70¹ të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, ndaj punëdhënësit është shqiptuar gjobë në vlerën prej 1 000 eurosh.
5. Ankesë për vlerësim pëformance të stafit të punëdhënësit, të parashtruar nga sindikata është trajtuar dhe refuzuar si e pabazuar.
6. Ankesë e punëtorit të ANP-së, e trajtuar dhe ku është konstatuar se ka cениm të dispozitës së nenit 27 (puna e natës), paragrafi 4, të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës dhe është shqiptuar gjobë në vlerën prej 1 700 eurosh, me Vendimin nr.01-25-52/2023.
7. Ankesë e punëtores së ANP-së, për angazhim të paligjshëm në orarin e punës së natës, është trajtuar dhe konstatuar se ka ceni të dispozitës së nenit 27, paragrafi 4, të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës dhe është shqiptuar gjobë në vlerën prej 1 000 eurosh, me Vendimin nr.01-25-81/2023.
8. Ankesë e sindikatës me pretendimin për diskriminim në hartimin e Kodit të Etikës në kuadër të punëdhënësit, është trajtuar dhe është konstatuar se ka ceni të dispozitës së nenit 95² të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, dhe është shqiptuar gjobë në vlerën prej 2000 eurosh, me Vendimin nr.01-25-73/2023.
9. Ankesë e punëtores së ANP-së për largim të paligjshëm nga puna, e trajtuar dhe konstatuar se ka ceni të dispozitës së nenit 71 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës (e cila përcakton kohën e njoftimit për ndërprerje të kontratës së punës nga punëdhënësi) dhe

¹ Neni 70 i Ligjit nr. 03/L -212 të Punës trajton rastet e ndërprerjes së kontratës së punës nga punëdhënësi.

² Neni 95 i Ligjit të Punës përcakton: "Punëdhënësit janë të obliguar që aktet e brendshme me të cilat rregullohen marrëdhëniat e punës, t'i harmonizojnë me dispozitat e këtij ligji, jo më vonë se gjashë (6) muaj pas hyrjes në fuqi të tij; 2. Deri në nxjerrjen e akteve të brendshme nga paragrafi 1. i këtij neni, drejtpërsëdrejtë aplikohen dispozitat e këtij ligji."

është shqiptuar gjobë në vlerën prej 1 000 eurosh, sipas Vendimit nr.01-56-104/2023-C.

10. Ankesë e punëtorit për ndalesë në paga, e trajtuar dhe konstatuar se ka cenim të dispozitës së nenit 85 (masat disiplinore për shkeljen e detyrave të punës) të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës dhe është shqiptuar gjobë në vlerën prej 2 500 eurosh, sipas Vendimit nr.01-56-183/2023.
11. Ankesë e punëtorit për masë disiplinore të kundërligjshme, e trajtuar dhe konstatuar se punëdhënësi ka cenuar dispozitën e nenit 85 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, rasti është në procedurë trajtimi me raport inspektues.
12. Çështja e z. Bashkim Latifit – kryetarit të Sindikatës, me pretendimin për cenim të aktivitetit sindikal është trajtuar nga IP-ja në Shkallë të parë, **e cila ka konstatuar se ka cenim të aktivitetit sindikal nga ana e punëdhënësit, me rastin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së z. Bashkim Latifit**, për arsyen e angazhimit të tij sindikal. Lënda është kthyer në procedurë të rishqyrtimit nga Shkalla e dytë e IP-së, nën pretendimin se inspektori i punës ka tejkaluar kompetencat me rastin e trajtimit të ankesës në momentin që ka ndërhyrë në çështjet kontestimore mes punëdhënësit dhe të punësuarit dhe rasti është kthyer në procedurë të rishqyrtimit të konstatimit të gjendjes faktike dhe për shqiptim të gjobës ndaj punëdhënësit për cenimin e dispozitave të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës.
15. Më 7 shtator 2023 përfaqësuesja e IAP-së ka takuar dhe ka diskutuar me zyrtarët përgjegjës të Departamentit Qendror për Partneritet Publiko-Privat, pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), lidhur me ankesën e pranuar nga kryetari i Sindikatës, me pretendimet për shkelje të të drejtave të punëtorëve të aeroportit, statusit ligjor dhe mbikëqyrjes që ka ANP-ja në raport me organet shtetërore në vend. Sipas informatës që kemi pranuar nga MFPT-ja, punëtorët që kanë qenë të punësuar në aeroport, në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes së koncesionit kanë pasur të garantuar punësimin për tri vjet e ardhshme me pagë dhe beneficione të njëjta, por jo edhe pozitë të njëjtë. Dhe më tutje, kompetencë për mbikëqyrje në kuptim të zbatimit të dispozitave të Ligjit të Punës kanë vetëm Inspektorati i Punës. Ata gjithashtu kanë njoftuar se, ndonëse ky departament ka për kompetencë kontrollimin e aktivitetit ekonomik të aeroportit, cilësisë së shërbimeve dhe ankesave të konsumatorëve, megjithatë kanë njoftuar se kanë pranuar informatë nga sindikata për pakënaqësitë e punëtorëve, të cilat janë diskutuar në instanca relevante dhe është provuar që të ndërmjetësohet për adresimin e problemeve.
16. Më 10 nëntor 2023, përfaqësuesja e IAP-së, përmes postës elektronike i është drejtuar Departamentit Qendror për Partneritet Publiko-Privat, pranë MFPT-së, me kërkesë për informata për mënyrën e rregullimit të të drejtave të punëtorëve sipas Kontratës së Koncesionit të Aeroportit.
17. Sipas përgjigjes që kemi pranuar po më 10 nëntor 2023 nga departamenti i lartpërmendur, IAP-ja është njoftuar: “*Sipas Marrëveshjes së Koncesionit “Të punësuarit e ANP-së” nënkuption çdo person i emëruar në Shtojcën 17. Gjithashtu në nenin 9 të kësaj Marrëveshje parashihen veprimet që i merr përsipër partneri privat në raport me punëtorët. Pika 9.1.9 Personeli dhe Trajnimet: Partneri Privat duhet me kosto dhe shpenzime të vetat të: (a) punësojë në ANP, apo të nxis punësimin apo ndryshe të*

angazhojë si personel në ANP, një numër të personave të trajnuar dhe me përvojë të mjaftueshme që të bëjë ANP-në operuese [...]; pika 9.18 Ndërprerja e punësimit të Personelit - Partneri Privat mund të ndërpres punësimin ose ndonjë angazhim të cilidto Punëtor të ANP së (i) në çdo kohë për shkaqet që lidhen me ligjet, rregullat, dhe rregulloret administrative dhe dekretet e aplikuara (ii) me marrëveshje reciproke, dhe (iii) pa kufizime pas përvjetorit të tretë (3) të datës së hyrjes në Fuqi. Data e hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje është 04 prill 2011.”

18. Kontrata për Partneritet Publiko-Privat, me nr. PPP-09-001-611, për operim dhe zgjerim të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, e nënshkruar ndërmjet Republikës së Kosovës, duke vepruar nga dhe përmes Komitetit Drejtues Ndërministror të Partneritetit Publiko-Privat, dhe Limak - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës J.S.C., më 12 gusht 2010, në nenin 9.18 parasheh: “*Ndërprerja e punës së personelit - Partneri privat mund të ndërpresë punësimin ose angazhimin tjetër të çdo punonjësi të ANP-së në çdo kohë për shkak të arsyeve në përputhje me ligjet, rregullat, rregulloret dhe dekretet në fuqi, me marrëveshje të ndërsjelltë dhe pa kufizim pas përvjetorit të tretë të datës së hyrjes në fuqi.*”
19. Më 23 shkurt 2024, përfaqësuesja e IAP-së, sipas vizitës së realizuar në Inspektoratin e Punës, është njoftuar se lidhur me çështjen e z. Latifit, përkitazi me kufizimin e aktivitetit sindikal, në procedurë të rishqyrtimit IP-ja ka nxjerrë një vendim dhe, sipas njoftimit përcjellë IAP-së, më 26 shkurt 2024, kuptohet se Inspektorati i Punës, më 1 shkurt 2024 ka nxjerrë Vendimin nr. 01/56-17/2024 për shqiptim të masës ndëshkimore. Në këtë vendim është konstatuar se punëdhënësi Limak Kosovo International Airport Prishtina është përgjegjëse për cenimin e dispozitave të Ligjit nr. 04-L011 për Organizimin Sindikal, neni 25 (ndalimi i ndërhyrjes), paragrafi 2, ku potencohet: “*Ndalohet çdo akt ndërhyrjeje në krijimin, funksionimin ose administrimin e organizatave sindikale nga punëdhënësit ose organizatat e punëdhënësve* [...]” dhe punëdhënësi ndëshkohet me gjobë në lartësi prej 2 000 (dymijë) eurosh.

Analiza ligjore

20. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 21, paragrafët 2 dhe 3, përcakton: “*Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë. Çdokush e ka për detyrë t'i respektojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të tjerëve.*”
21. Parimi i trajtimit të barabartë, si ndër parimet themelore, pasqyrohet në nenin 24, paragrafët 1 dhe 2, të Kushtetutës, ku përcaktohet: “*Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gjëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. 2. Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal.*”
22. Po ashtu edhe liria e asociimit është e garantuar dhe e mbrojtur me Kushtetutë, e cila në nenin 44, paragrafët 1 dhe 2, parasheh: “*Liria e asociimit është e garantuar. Liria e asociimit ngërthen të drejtën e secilit për të themeluar një organizatë pa pasur nevojë të sigurojë leje, për të qenë ose për të mos qenë anëtar i një organizate, si dhe për të marrë pjesë në aktivitete të një organizate.*” “*Liria për të themeluar sindikata dhe për t'u*

organizuar, me qëllim që të mbrohen interesat, është e garantuar. Kufizimi i kësaj të drejte mund të bëhet me ligj për kategoritë veçanta të punonjësve.”

23. Liria e asociimit po ashtu është e paraparë dhe e mbrojtur me nenin 11, paragrafi 1, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNj), ku potencohet: “*Çdokush ka të drejtën e lirisë së tubimit paqësor dhe të organizimit me të tjerët, duke përfshirë të drejtën e themelimit me të tjerë të sindikatave dhe të pjesëmarrjes në to për mbrojtjen e interesave të tij*”, ndërsa paragrafi 2 i këtij nenit përcakton: “*Ushtrimi i këtyre të drejtave nuk mund t'u nënshtronhet kufizimeve të tjera përveç atyre që parashikohen me ligj dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare ose sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit dhe parandalimin e krimtit, për ruajtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të të tjerëve [...].*”

24. Në fymën e nenit 13 të KEDNj-së: “*Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përbushje të funksioneve të tyre zyrtare.*”

25. Liria e asociimit është e garantuar edhe me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut, e cila në nenin 20 (E Drejta e Tubimit Paqësor dhe Asociimit), paragrafi 1, përcakton: “*Gjithkush ka të drejtën e lirisë së tubimit dhe organizimit paqësor.*”

26. Më tej nenit 23 i Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut proklamon të drejtën për kushte dhe pagë të barabartë në punë si dhe të drejtën për formim dhe anëtarësim në organizata për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave, ashtu që e njëjtë parashesh: “*Gjithkush ka të drejtën për punë, të zgjedhë lirisht profesionin, të ketë kushte të favorshme pune dhe të jetë i mbrojtur nga papunësia. 2. Gjithkush, pa kurrfarë diskriminimi, ka të drejtë që për punë të njëjtë të marrë rrogë të njëjtë. 3. Gjithkush që punon ka të drejtën për një shpërblim të drejtë dhe favorshëm, në mënyrë që t'i sigurojë atij dhe familjes së tij një jetë që i përgjigjet dinjitetit njerëzor dhe, në qoftë se do të jetë e nevojshme ky shpërblim të plotësohet edhe me mjete të tjera të sigurimit shoqëror. 4. Gjithkush ka të drejtë të formojë sindikatë and të bëjë pjesë në të pér mbrojtjen e interesave të veta.*”

27. Gjithashtu edhe Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, në nenin 21, parashesh: “*Njihet e drejta e mbledhjes paqësore. Ushtrimi i kësaj të drejte mund të jetë objekt vetëm i kufizimeve që diktohen sipas ligjit dhe që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë kombëtare, të qetësisë dhe rendit publik ose për të mbrojtur shëndetin ose moralin publik apo të drejtata dhe liritë e të tjerëve.*”

28. Konventa nr. 87, për Lirinë e Asociimit dhe të mbrojtjes të së drejtës pér organizim e Organizatës Botërore të Punës, në nenin 2 parashesh: “*Punëtorët dhe punëdhënësit, pa asnjë dallim, do të kenë të drejtën të krijojnë dhe, duke iu nënshtruar vetëm rregullave të organizatës në ffalë, t'i bashkohen organizatave sipas zgjedhjes së tyre, e pa autorizim paraprak.*”

29. Ndërkëq trajtimi i barabartë dhe pa dallim mbi çfarëdo baze, përfshirë këtu edhe dallimin mbi bazën e asociimit, janë vlera të mbrojtura dhe parime të përcaktuara edhe me Ligjin nr. 05/L-031 pér Mbrojtje nga Diskriminimi. Ashtu që ligji, në nenin 2, parashesh: “*Ky ligj zhatohet pér të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe*

lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me: 1.1. kushtet për qasje në punësim, vetëpunësim dhe punësimin në profesion, përfshirë këtu kushtet e punësimit, kriteret e përgjedhjes, pa marrë parasysh aktivitetin në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale, përfshirë avancimet; 1.2. qasje në të gjitha llojet dhe nivelet e udhëheqjes profesionale, trajnimeve profesionale, trajnimit të avancuar profesional dhe rikualifikimet përfshirë edhe përvojën e punës praktike; 1.3. kushtet e punësimit dhe të punës, përfshirë shkarkimin apo ndërprerjen e kontratës dhe pagesës; 1.4. anëtarësimin dhe përfshirjen në organizata të punëtorëve ose të punëdhënësve apo në çdo organizatë tjeter anëtarët e së cilës ushtrojnë një profesion të caktuar, përfshirë edhe përfitimet që mundësohen nga organizatat e tillë; [...].”

30. Ndërsa neni 3 i Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi përcakton: “*1. Parimi i trajtimit të barabartë nënkuption se nuk do të ketë kurrfarë diskriminimi të drejtpërdrejtë apo të tërthortë sipas kuptimit të cilëdo nga bazat e përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji. 2. Diskriminimi është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë në çfarëdo baze të përcaktuara në nenin një (1) të këtij Ligji, që ka për qëllim apo efekt të zhvleftësoj ose cënoj njohjen, gëzimin ose ushtrimin, në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave dhe lirive themelore të njohura nga Kushtetuta dhe ligjet tjera të aplikueshme në Republikën e Kosovës.*”
31. Se diskriminimi në punësim dhe në kushte të punës është i ndaluar, e përcakton edhe Ligji nr. 03/L-212 i Punës, i cili në nenin 5, paragrafi 1, parasheh: “*Diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim, trajnimin, promovimin e punësimit, kushtet e punësimit, masat disiplinore, ndërprerjen e kontratës së punës ose çështjeve të tjera nga marrëdhënia e punës të rregulluara me këtë ligj dhe me ligjet e tjera në fuqi.*”
32. Ligji i Punës po ashtu e parasheh edhe lirinë e organizimit sindikal, ashtu që në nenin 88 (Liria e organizimit sindikal) shprehimisht përcaktohet: “*Të punësuarve dhe punëdhënësve u garantohet liria e asocimit dhe veprimi pa ndërhyrje nga asnjë organizatë ose organ publik. Të drejtat dhe liritë e organizimit sindikal në Republikën e Kosovës rregullohen me ligj të veçantë.*”
33. Përveç lirisë së asociimit dhe organizimit sindikal, edhe e drejta e grevës është e drejtë e garantuar. Ligji i Punës, në nenin 89 (E drejta e grevës), përcakton: “*Për mbrojtjen e të drejtave të të punësuarve, organizatat e të punësuarve (sindikatat) kanë të drejtën e organizimit të grevës; Të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë për organizimin dhe pjesëmarrjen në grevë rregullohen me ligj të veçantë.*”
34. Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji e bën Inspektorati i Punës, kjo sipas nenit 94 të Ligjit të Punës, ku thuhet: “*Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji të cilat e rregullojnë marrëdhënien e punës, sigurinë dhe mbrojtjen në punë, e bën Inspektorati i Punës në bazë të Ligjit për Inspektoratin e Punës [...].*”
35. Për më tepër, Ligji nr. 04/-L-011 për Organizimin Sindikal në Kosovë rregullon dhe përcakton të drejtat dhe liritë e të punësuarve për themelimin dhe organizimin e lirë dhe vullnetar në organizata sindikale në sektorin publik dhe privat, me qëllim të përfaqësimit

dhe mbrojtjes së interesave ekonomike, sociale dhe profesionale të punëtorëve nga puna dhe marrëdhënia e punës.

36. Ligji, në nenin 3 (E drejta për bashkim), parasheh: “*Të punësuarit kanë të drejtë sipas vullnetit të tyre të themelojnë organizata sindikale, të anëtarësohen dhe bashkohen në to, sipas këtij ligji, Statutit Sindikal dhe standardeve ndërkombëtare sindikale dhe Konventave Ndërkombëtare të ONP-së.*”
37. Ndërsa diskriminimi mbi bazën e asociimit shprehimisht ndalohet me nenin 4 të këtij ligji, e cila në paragrafin 2, decidivisht përcakton: “*Askush nuk duhet të jetë i diskriminuar, apo ti cenohen të drejtat e të punësuarit për shkak të anëtarësimit, mosanëtarësimit në organizatë sindikale, për aktivitet sindikal në organizatën sindikale.*”
38. Po ashtu, ligji përcakton edhe obligimet e punëdhënësit në raport me krijimin e kushteve për ushtrimin e aktivitetit sindikal, ashtu që në nenin 7 (Krijimi i kushteve për veprim sindikal nga punëdhënësi) parashihet: “*1. Punëdhënësi duhet të krijojë kushte dhe lehtësira të nevojshme për përfaqësuesit e zgjedhur të organizatave sindikale, për veprim sindikal të të punësuarëve; 2. Për krijimin e kushteve të volitshme për veprim sindikal, punëdhënësi duhet të angazhohet në: 2.1. lejimin e qarkullimit në mjediset e ambinetit të punës; 2.2. lejimin e shpërndarjes së njostimeve, broshurave, publikimeve dhe dokumenteve të tjera të organizatës sindikale për aktivitete sindikale; 2.3. ligurimin e kohës së nevojshme për aktivitet sindikal brenda dhe jashtë vendit; 2.4. krijimin dhe ofrimin e lehtësirave për grumbullimin e mjetave të kuotizimit si; dhe 2.5. krijimin e kushteve optimale për funksionimin e sindikatës, duke përfshirë organizimin e mbledhjeve dhe takimeve të ndryshme sindikale.*”
39. Po ashtu, Ligji nr. 04/-L-011 për Organizimin Sindikal ndalon shprehimisht diskriminimin për shkak të aktivitetit sindikal. Neni 24 (Imuniteti i përfaqësuesve sindikalë) përcakton: “*1. Ndalohet diskriminimi ndaj përfaqësuesve të organizatave sindikale. 2. Për aktivitete sindikale, përfaqësuesit sindikal, pa pëlqimin e sindikatës nuk mund t'i: 2.1. ndërpritet kontrata e punës; 2.2. caktohet vend tjeter i punës; 2.3. ulet pozita e vendit të punës; 2.4. fillojë procedura disiplinore; 2.5. zvogëlohet paga.*” Andaj mund të konsiderohet se ekziston baza e mjaftueshme ligjore për mbrojtjen e punëtorëve nga çfarëdo përpjekje për diskriminim dhe ndërprerje të marrëdhënieve së punës, për shkak të asociimit në sindikatë dhe pjesëmarrjes në aktivitete sindikale.
40. Neni 27 (Presioni sindikal dhe e drejta në grevë) i ligjit të lartpërmendur i parasheh grevat si një mjet demokratik për realizimin e kërkesave sindikale, ashtu që parasheh: “*1. Për realizimin e kërkesave sindikale lejohen format e presionit sindikal, si protestat dhe grevat e punëtorëve në pajtim me Konventat Ndërkombëtare, ligjet e aplikueshme dhe Statutin sindikal. 2. E drejta në grevë është një e drejtë elementare e të punësuarve dhe organizmave sindikalë e cila në Kosovë garantonohet me Ligjin për Greva. 3. Gjatë organizimit të formave të presionit sindikal, ndalohet përdorimi i dhunës nga ana e të punësuarve. 4. Ndalohet përdorimi i dhunës dhe marrja e masave ndëshkuuese nga punëdhënësit, ndaj të punësuarve që kanë marrë pjesë në një protestë dhe grevë sindikale të ligjshme.*”
41. Inspektorati i Punës është autoriteti kompetent me kompetencë mbikëqyrjen e zbatimit të këtij ligji, sipas nenit 32, parografi 2, të Ligjit nr. 04/-L-011 për Organizimin Sindikal.

42. Se e drejta në grevë është e drejtë elementare e punëtorëve dhe se punëtorët nuk mund të diskriminohen e as të largohen nga puna për shkak të shfrytëzimit të kësaj të drejte, e thotë shprehimisht edhe Ligji nr. 03/L-200 për Greva. Neni 11 (E drejta për grevë) garanton: “*1. Pjesëmarrja në greva lejohet nëse parashihet me ligj, me kontratën kolektive dhe me statutin e sindikatës. 2. I punësuari nuk mund të jetë i diskriminuar për shkak të organizimit dhe pjesëmarrjes në grevë; 3. Punëtorit nuk mund t’i ndalohet e drejta për grevë, as të përdoret masa e ndëshkimit për të përfunduar grevën në kuptim të paragrafit 1. të këtij nenit. 4. Ndaj të punësuarit mund të inicohet procedurë disiplinore, për organizimin dhe pjesëmarrjen në grevën që është në kundërshtim me ligjin.*”
43. Po ashtu, mbrojtjen e të drejtave të të punësuarve gjatë kohës së grevës i parasheh shprehimisht edhe neni 13 i Ligjit për Greva, ku thuhet: “*1. Për organizuesit e grevës, pjesëmarrësve grevistë dhe ndaj të punësuarve të tjera, të cilët mbështesin grevën, nuk mund të merren masa disiplinore apo materiale dhe nuk mund t’ju ndërpritet marrëdhënia e punës. 2. Gjatë grevës së organizuar sipas kushteve të përcaktuara me këtë Ligj, punëdhënësit nuk mund të punësojnë punëtorë të rindërtuar të cilët do të zëvendësonin pjesëmarrësit në grevë.*”
44. Mbikëqyrjen për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, të Kontratës Kolektive dhe të akteve nënligjore, me të cilat mund të shkelen të drejtat dhe detyrat e punëtorëve, përkatësisht të punëdhënësve, lidhur me grevën dhe pjesëmarrjen në grevë, e bën Inspektorati i Punës, kjo sipas përcaktimeve të nenit 23 të ligjit të lartpërmendur.
45. Poashtu Ligji nr. 04/L-045 për Partneritet Publiko Privat, në nenet 16, 17 dhe 18 të ligjit, përcakton kompetencat e Komitetit për Partneritet Publiko Privat si dhe kompetencat e Departamentit Qendror për Partneritetin Publiko Privat në kuadër të Ministrisë së Financave. Rrjedhimisht neni 16 i ligjit ndër të tjera përcakton: “*Komiteti për Partneritetin Publiko-Private mbikëqyrë dhe bashkërendon projektet e partneritetit publiko-privat në të gjithë sektorët ekonomik dhe shoqëror. KPPP përbëhet prej pesë (5) anëtarëve të përhershëm. Ministri për Financa është anëtar i përhershëm i KPPP dhe është kryesuesi i KPPP..... Ministri i Financave drejton dhe koordinon aktivitetet e KPPP si dhe shërben si kryesues i saj.*” Më tej neni 18 i ligjit parasheh: “*Departamenti Qendror për Partneritetin Publiko Privat (Departamenti PPP) themelohet në kuadër të Ministrisë së Financave për të ndihmuar dhe këshilluar KPPP, Ministrinë e Financave dhe Autoritetet e tjera Publike për të gjitha aktivitetet që ndërlidhen me Partneritetin Publiko Privat. Departamenti PPP i raporton dhe i përgjigjet në mënyrë të drejtpërdrejtë KPPP.*”

Vlerësimet e Avokatit të Popullit

46. Pas analizimit të bazës ligjore, të fakteve dhe të pretendimeve të paraqitura në këtë çështje, Avokati i Popullit sjell në vëmendje se liria e asociimit është një e drejtë themelore e njeriut, e mbrojtur dhe e garantuar me akte ndërkombëtare dhe vendore, dhe njëherësh është tregues për nivelin e funksionimit të demokracisë në shoqërinë bashkëkohore. Kjo përfaktin se shoqatat sindikale kanë një rol të rëndësishëm në përfaqësimin e të drejtave të punëtorëve, dëgjimin e kërkeshave të tyre dhe promovimin e mbrojtjes së të drejtave themelore nga marrëdhënia e punës.
47. Anëtarësimi në sindikatë dhe angazhimi në aktivitete sindikale nuk do të duhej të ndikonin apo ta zvogëlonin nivelin e gëzimit të të drejtave themelore nga marrëdhënia e punës, e po ashtu nuk mund të jenë faktorë për trajtim të pabarabartë në raport me të

tjerët. Sikurse është paraqitur edhe më lart, korniza ligjore në fuqi jep hapësirë të mjaftueshme dhe të drejta të garantuara punëtorëve për ushtrimin e aktiviteteve sindikale. Gjithashtu dispozitat ligjore obligojnë punëdhënësin për krijimin e kushteve për ushtrim të aktiviteteve sindikale dhe njëkohësisht ndalojnë cenimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës apo çfarëdo diskriminimi mbi bazën e asociaimit në sindikatë.

48. Nga faktet dhe analiza e rastit të ngritur nga z. Latifi, në cilësi të kryetarit të Sindikatës së Punëtorëve të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës, vërehet se nuk janë respektuar dispozitat përkatëse të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, i cili ndalon diskriminimin mbi bazën e lirisë së asociaimit; të Ligjit të Punës; të Ligjit për Organizimin Sindikal dhe të Ligjit për Greva.
49. GjEDNj-ja nëpërmjet praktikës së saj gjyqësore, duke proklamuar rëndësinë e garantimit dhe respektimit të lirisë së asociaimit, ka theksuar ndalimin e çfarëdo diskriminimi në gjëzimin e të drejtave themelore, mbi këtë bazë. GjEDNj-ja, në rastin Sanchez Navajas v. Spain 2001, kishte theksuar se përfaqësuesit e punëtorëve duhet, si irregull, dhe brenda disa kufijve, të gëzojnë lehtësira të përshtatshme për t'u mundësuar atyre t'i kryejnë funksionet e tyre sindikale me shpejtësi dhe në mënyrë efektive, e që ky nuk është rasti i z. Latifit. Në këtë drejtim mund të vlerësohet se moslejimi i z. Latifit, në cilësi të kryetarit të Sindikatës, që të ketë qasje në hapësirat e Sindikatës dhe në dosjet, përbën shkelje dhe kufizim të lirisë së organizimit sindikal.
50. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit sjell në vëmendje se sipas qëndrimeve të Udhëzuesit të Komisionit të Venecias, përkitazi me lirinë e asociaimit, theksohet: "*Liria e organizimit është një e drejtë themelore e njeriut që është thelbësore për funksionimin e një demokracie. Ai përbën një kusht thelbësor për ushtrimin e të drejtave të tjera të njeriut.*"
51. Rëndësinë e respektimit të lirisë së asociaimit, si tregues i shkallës së zhvillimit të demokracisë, e ka konfirmuar edhe GjEDNj-ja në rastin Sidiropoulos and others v. Greece, ku është theksuar se aftësia për të formuar një entitet juridik për të vepruar kolektivisht në një fushë me interes të ndërsjellë është një nga aspektet më të rëndësishme të së drejtës. Mënyra se si legjislacioni kombëtar e garanton këtë liri dhe zbatimi i saj praktikë nga autoritetet është tregues i një pjese jetike të gjendjes së demokracisë në një vend.
52. GjEDNj-ja po ashtu edhe në rastin Danilenkov and Others v. Russia, 2009, që kishte të bënte me anëtarët e Unionit të Dokerëve të Rusisë, të larguar nga puna për arsyetim të ristrukturimit të kompanisë, të cilët kishin marrë pjesë në një grevë dyjavore me kërkësë për paga më të mira, kushte më të mira pune dhe sigurim shëndetësor dhe jetësor, kishte konstatuar shkelje të nenit 14 – Ndalimi i diskriminimit, në raport me nenin 11 të Konventës.
53. Në rastin Kaya dhe Seyhan v. Turkey 2009, që kishte të bënte me mësuesit ndaj të cilëve ishin aplikuar masat disiplinore, për shkak të pjesëmarrjes në grevë e organizuar nga sindikata, GjEDNj-ja kishte konstatuar se ishte shkelur nenit 11 i Konventës, pasi masat, ndonëse të lehta, të ndërmarra ndaj tyre, kishin qenë të tillë që të largonin anëtarët e sindikatës në pjesëmarrjen në grevë, ose veprime të tjera sindikale dhe si të tillë nuk janë të nevojshme në një shoqëri demokratike.

Përfundim

Avokati i Popullit, nga analiza e çështjes konstaton se në çështjen e ngritur, ANP-ja ka kufizuar ushtrimin e aktivitetit sindikal të kryetarit të Sindikatës, duke penguar qasjen në hapësira të Sindikatës dhe duke cenuar të drejtat e garantuara me Ligjin për Organizimin Sindikal.


Avokati i Popullit, vlerëson se çdo largim eventual nga puna apo cënimi i të drejtave nga marrëdhënia e punës e punëtorëve, për shkak të aktivitetit sindikal, përbën diskriminim mbi bazën e lirisë së asociimit.

Sipas kuadrit ligjor në fuqi, të drejtat e garantuara dhe të mbrojtura me Kushtetutë dhe me Ligjin e Punës, për mosdiskriminim dhe trajtim të barabartë në kushtet e punës nuk mund të cenohen për grupe të caktuara të punëtorëve për shkak të ushtrimit të aktivitetit sindikal apo pjesëmarrjes së tyre në greva për kërkim të kushteve më të mira të punës. Po ashtu inicimi i masave disiplinore deri te largimi nga puna, për shkak të aktivitetit sindikal apo pjesëmarrjes në greva përbën një mjet jodemokratik të komunikimit punëdhënës dhe punëmarrës, e gjithashtu mjet kufizimi që cenon të drejtat e punëtorëve për kërkesë për kushte më të mira pune.

Avokati i Popullit vlerëson se institucionet përgjegjëse duhet të japid vëmendjen e duhur mbikëqyrjes së respektimit të plotë të dispozitave të Ligjit të Punës dhe Ligjit për Organizim Sindikal, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave që rrjedhin nga marrëdhënia e punës dhe organizimit të aktivitetit sindikal, të punëtorëve të Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës “Adem Jashari”.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit vlerëson se autoritetet duhet t'i ndërmarrin masat e nevojshme që garantojnë ushtrimin e aktivitetit sindikal të kryetarit të Shoqatës sindikale të ANP dhe të punëtorëve të aeroportit, pa ndonjë ndikim në trajtimin e pabarabartë, në raport me punëtorët jo anëtarë të sindikatës. Gjithashtu e vlerëson si të nevojshme gjetjen e modaliteteve të komunikimit dhe të lejimit të ushtrimit të aktivitetit sindikal në hapësirat e rezervuara për Sindikatën nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës Adem Jashari.

Po ashtu Avokati i Popullit thekson nevojën për ndërtimin e një komunikimi të mirfillt dhe dialogut me Shoqatën Sindikale, në mënyrë që të trajtohen dhe të konsiderohen edhe propozimet e Shoqatës Sindikale si përfaqësuese e interesave të punëtorëve të aeroportit në proceset e politikëbërjes në institucion, duke kontribuar kështu edhe në ndërtimin e një komunikimi të mirëfilltë në raportet punëdhënës dhe punëmarrës.


Me nderime,
Naim Qelaj
Avokat i Popullit